



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 393/6 prot.

Tiranë, më 12.11.2020

**Lënda:** Raport i Komisionerit Publik lidhur me të drejtën e mosankimit kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala

**Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

**Për dijeni:** Komisionerit Publik, z. Ballhysa

**Baza ligjore:** Neni B i Kushtetutës, prg. 3, pika c

**Të nderuar zonja/zotërinj,**

Ashtu sikurse jeni në dijeni, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 11.11.2020, është depozituar akti: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga tre Vëzhgues Ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, znj. \*\*\*,\*\*, z. \*\*\*,\*\*, z. \*\*\*,\*\*, në të cilin rekomandohet paraqitja e ankimit ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik i parë, në këtë vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ishte z. Darjel Sina. Brenda afatit ligjor, të vendosur nga rregullorja e brendshme e Institucionit të Komisionerëve Publikë,<sup>1</sup> në datën 6.11.2020, Komisioneri, me *email* zyrtar, ka shprehur vullnetin e tij për mosushtrim ankimi ndaj këtij vendimi, kolegut të tij, z. Ballhysa, dhe dy anëtarëve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, z. \*\*\*,\*\* dhe znj. \*\*\*,\*\*. Përpara kësaj vendimmarrje, Komisioneri Publik Darjel Sina, në datën 5.11.2020, ka bërë një takim *online*, në orën 10 të mesditës, me z. \*\*\*,\*\* dhe skuadrën e tij, takim në të cilin u diskutuan çështjet konkrete të subjektit të rivlerësimit dhe, në fund, u ra dakord që z. Sina nuk do të ushtronte të drejtën e tij të ankimit. Në datën 11.11.2020, në orën 16.30, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dërgon pranë zyrave të Institucionit të Komisionerëve Publikë një rekomandim për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala. Nga përmbajtja e rekomandimit, i vetmi element i ri që gjendet brenda tij është një denoncim anonim, i cili nga përmbajtja e tij nuk rezulton se sjell prova të reja për subjektin e rivlerësimit. Më poshtë po shpjegoj në detaje arsyet e mosushtrimit të ankimit nga ana ime.

<sup>1</sup> Neni 15 i rregullores së Komisionerëve Publikë dhe, konkretisht, pikat 3, 5, dhe 7.

## I. Përmbledhje e rekomandimit të ONM-së

ONM, me anë të aktit: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, ka rekomanduar Komisionerin Publik të ushtrojë ankim për hetim të mëtejshëm dhe vlerësim të duhur të standardeve juridike dhe financiare të subjektit të rivlerësimit, bazuar në jurisprudencën e KPA-së, bazuar në mënyrë të përmbledhur, mbi këto tematika:

- i. Përmbledhje e çështjeve lidhur me pronësinë;
- ii. Kontrata e huas për të cilën ekziston një akt noterial i vitit 2015;
- iii. Analiza financiare për periudhën 2003-2016;
- iv. Shqyrtimi i denoncimit anonim, të ardhur në 10.11.2020, pranë ONM-së;
- v. Analizë e një vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. \*\*\*, i datës \*\*\*.7.2017.

### A. Përmbledhje e çështjeve lidhur me pronësinë

#### Pasuri nr. 1, “Shtesë me sip. 35.4 m<sup>2</sup>”, realizuar në vitin 1998

Për shtesën me sipërfaqe 35.4 m<sup>2</sup>, deklaruar si e ndërtuar në vitin 1998, subjekti i rivlerësimit, në mendimin e Komisionerit Publik, provoi vlerën e ndërtimit të saj nëpërmjet aktit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i cili ishte raporti i ekspertimit teknik, i hartuar<sup>2</sup> nga eksperti i licencuar, për nevoja të procesit të rivlerësimit, të cilin Komisioni e ka vlerësuar si të mjaftueshëm për të krijuar bindjen se s. r. i ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi.

**Komisioneri Publik ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit në këtë çështje.**

#### Pasuria nr.2

*Apartament i blerë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me sip.79 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, me vlerë 19.000 USD, kontratë e shitblerjes datë \*\*\*.12.2000*

#### Lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie

*Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit deklaron: Blerje apartament nga shoqëria “\*\*\*”, me sip. 79 m<sup>2</sup>, sipas kontratës<sup>3</sup> së datës \*\*\*.12.2000, vlera 19.000 USD, me burim kursimet familjare të ardhura nga paga ime si gjyqtar, si dhe nga kursimet e prindërve të mi. Pjesa takuese 100%. Në pikën 6 të rubrikës “Deklarimi i pasurive”, subjekti deklaron: Shkëmbim apartamenti, sipas deklaratës noteriale nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2004, në natyrë, pa kompensime financiare. Pjesa takuese 100%. Në pikën 7 të rubrikës: “Deklarimi i pasurive”, subjekti deklaron: Shitje apartament banimi me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, sipas kontratës<sup>4</sup> së datës \*\*\*.9.2004, për çmimin 1.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%.*

Gjatë hetimit administrativ dhe, konkretisht, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, Pyetësorit nr. 5 dhe të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, pretendon se: *kjo banesë nuk ka qenë asnjëherë “de facto” prona ime, por e familjes së tezes së tij dhe arsyet dhe rrethanat i ka shpjeguar vetëm gjatë hetimit administrativ.*

<sup>2</sup> Në muajin qershor 2020.

<sup>3</sup> Kontratë noteriale nr.\*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2000.

<sup>4</sup> Kontratë noteriale nr.\*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol, datë \*\*\*.9.2004.

Bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit lidhur me këtë pasuri, si dhe bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e depozituara prej tij gjatë hetimit administrativ, Komisioneri Publik ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të blera nga subjekti dhe familjarët e tij deri në fund të vitit 2000. Komisioneri Publik i rezulton se subjekti dhe prindërit e tij nuk mbulojnë shpenzimet, investimin e shtesës me sip 35.4 m<sup>2</sup> dhe huadhënien për një diferencë negative prej -540.379 lekë.

## **II. Kontrata e huas për të cilën ekziston një akt noterial i vitit 2015**

Në lidhje me hetimin e kontratës së huas, Komisioneri Publik mbështet veprimet e ndërmarra nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është mbështetur në bindjen e tij të brendshme që kjo hua nuk ndikon në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Shala.

## **III. Analiza financiare për periudhën 2003-2016. Balanca negative ndër vite**

Nga aktet në dosje, rezulton se Komisioni ka kryer analizën financiare për vitet 2003 – 2016, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve, shpenzimeve dhe investimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtyre viteve dhe, në përfundim, i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me një pamjaftueshmëri në vlerën -681.184 lekë, në vitin 2015 dhe -195.974 lekë, për vitin 2016.

Përveç sa më sipër konstatuar nga Komisioni, nga analizimi i akteve të administruara në dosje, na rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me një pamjaftueshmëri edhe në vitin 2007, që llogaritet në një vlerë rreth -300.000 lekë, pasi: shtesa e likuiditeteve *cash*, bazuar në deklarin e subjektit në DV-2007 është 1.000.000 lekë<sup>5</sup>.

**Komisioneri Publik konkludon që diferenca negative ndër vite e subjektit të rivlerësimit është e justifikueshme dhe, bazuar në standardet e vendosura tashmë nga Komisioneri Publikë, në raste të ngjashme, nuk janë ankimuar vendime kur diferenca negative ndër vite nuk kalon një shumë të caktuar.**

## **IV. Përmbledhje e denoncimit anonim lidhur me kriterin e figurës**

Sikurse u citua më sipër, në datën 11.11.2020, në zyrat e Institucionit të Komisionerëve Publikë, ka ardhur rekomandimi i ONM-së me nr. prot. 865/1, datë 11.11.2020. Në këtë rekomandim gjendet një denoncim anonim nga një person i paidentifikuar në të dhënat e tij. Pretendimi i këtij individ për subjektin e rivlerësimit është mbajtja e 15% të aksioneve nga ana e z. Genti Shala në firmën “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”, me administrator z. \*\*\*.\*\*\*. Ndërkohë në brendësi të këtij denoncimi gjendet dhe ekstrakti historik i kompanisë, ku shihet qartë që aksionet e kësaj kompanie i zotëron të gjitha z. \*\*\* dhe emri i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet në asnjë lëvizje.

---

<sup>5</sup> Në likuiditetet e vitit 2007 përveç likuiditeteve në llogari bankare është konsideruar si shtesë e vitit shtesa cash 1.000.000 dhe si pakësim shuma 600.000 lekë që është përdorur për blerjen e automjetit në shkurt 2007.

**Komisioneri Publik, bazuar dhe në vendimmarrjet e KPA-së, si në rastin e subjektit të rivlerësimit z. \*\*\*.\*\*\*, gjen të arsyeshme të citojë që denoncimet anonime, të cilat nuk përmbajnë asnjë provë dhe nuk identifikojnë asnjë të dhënë të denoncuesit, duhet të mos merren parasysh. Për këtë arsye, Komisioneri Publik mendon që ky denoncim nuk përmban rrethana ose fakte që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, sikurse citon dhe neni 53 i ligjit nr. 84/2016.**

#### **V. Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2017, i Gjykatës së Apelit Tiranë**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nëpërmjet vendimmarrjes së tij, ka transferuar vendimin nr. \*\*\*, të datës \*\*\*.7.2020, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**Komisioneri Publik mbështet vendimmarrjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe ndan të njëjtin qëndrim me të. Bazuar në nenin e mësipërm, organi inspektues është ai që do të evidentojë shkaqe të shkeljeve disiplinore, në rast se ka.**

Komisioneri Publik Darjel Sina i qëndron vendimmarrjes së tij të datës 6.11.2020, vendimmarrje, e cila i është komunikuar me *email* zyrtar dy anëtarëve e tjerë të ONM-së, z. \*\*\*.\*\*\* dhe znj. \*\*\*.\*\*\*, sikurse dhe Komisionerit tjetër Publik, z. Florian Ballhysa, për mosushtrim ankimi ndaj vendimit nr. 286/Mr. Genti Shala, bazuar në arsyet e analizuara më sipër. Komisioneri Darjel Sina, bazuar në bindjen e tij të brendshme dhe të provave të analizuara gjatë hetimit të këtij vendimi, i qëndron vendimmarrjes së tij për mosushtrim ankimi ndaj vendimit të mësipërm të KPK-së.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**